



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministra Pravde – Office of Minister of Justice

Nr. 65 /2021
Datë: 06 / 04 / 2021

Në mbështetje të nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke marr parasysh nenin 55 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi nr. 116/2020 dt. 23.12.2020 me numër te protokollit 01-970 dt. 23.12.2020, për emërimin e Sekretarisë për procesin e përgatitjes së analizës për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Mekanizmi i Sekretarisë për procesin e përgatitjes së analizës për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe funksioni i tij nuk është kategori ligjore përkatësisht i paraparë në legjislacionin përkatës në fuqi, që më pas të përcaktohet me Vendim të Ministrit të Drejtësisë. Rrjedhimisht duke mos qenë kategori ligjore, kjo Sekretaria nuk ka funksion që më pas të mund të përcaktohet mandati funksional me Vendim të Ministrit të Drejtësisë, për faktin se nuk ka bazë ligjore nga e cila mund të rrjedhë.

Duke mos pasur bazë ligjore funksionale Sekretaria për procesin e përgatitjes së analizës për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, rrjedhimisht nuk ka bazë ligjore edhe kompensimi. Andaj nga vlerësimi i këtij Vendimi e në harmoni të plotë me legjislacionin përkatës në fuqi, një mekanizëm siç është përcaktuar në Vendimin Vendimi nr. 116/2020 dt. 23.12.2020 me numër të

protokollit 01-970 dt. 23.12.2020 nuk ka bazë ligjore funksionale dhe për këtë nuk mund të përcaktohet kompensim për këtë shërbim.

Duke u bazuar në programin qeverisës, Ministria e Drejtësisë do të angazhohet me prioritet për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës.



Vendimi i dërgohet:

- Z . Jahja Lluka;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Arkivit të MD-së.